



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 3569 Prot.

Patos më, 20/09/2024

Kryetari
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 70, datë 20.09.2024

**MBI NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024 NË TRANSFERTËN E
PAKUSHTËZUAR, MIRATUAR ME VKB NR. 81 DATË. 18.12.2023**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore, neni 54/dh, Ligjit nr.68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 23 paragrafi "Transferta e pakushtëzuar", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat Standarte të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024", dhe ligjit nr 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" si dhe në shkresën e dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr.11788, datë 04.09.2024, grupi i punës pasi ka relatuar mbi shtesën e buxhetit nga Transferta shtesë e Pakushtëzuar, paraqet materialin në Këshillin Bashkiak dhe,

KËRKON:

1. Të miratojë shtesën e të ardhurave në buxhetin e vitit 2024 në vlerën 9,731,030 lekë. (Si pjesë e transfertës së pakushtëzuar) sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Të miratojë shtesën e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2024 në vlerën 9,731,030 lekë, për mbulimin e shpenzimeve shtesë të personelit, në të gjitha programet që preken nga zbatimi VKM nr. 503 dt.01.08.2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Agjencia e Shërbimeve Publike .

Për Drejtorinë e Financës
Mimoza Shtëmbari

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Juella Shpata

Për Sektorin Juridik

Nurkë Hazizaj

Bashkia PATOS

Shpërndarje e shtesës së fondit sipas VKM nr.503 dt. 01.08.2024

ent/ QEV	Min is e linj es	Kodi I Institucionit	Emertimi I Institc	Kapi tulli	Programi	Llog.Ekono mike	Kodi I D.thes arit	Kodi Produktit	Emertimi I Produktit	Shuma
SHTOHET:										
112	0 0	2112001/09	B/Patos	0 1	110-10430	600	0 909	9999999	Shpenzime	8,338,480
112	0 0	2112001/09	B/Patos	0 1	110-10430	601	0 909	9999999	Shpenzime Sig.Shoqerore	1,392,550
shuma:										9,731,030
Shtohet kesh limiti										
112	0 0	2112001	B/Patos	0	0	6009999	0 909		Shpenzime personeli	9,731,030
										9,731,030

Dr.Finance
Mimoza SHTËMBARI

KRYETARI
Fation DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 3769/Prot.

Patos më, 20 / 09 / 2024

Lënda: Relacion mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2024 në Transfertën e pakushtëzuar,
Miratuar me VKB nr. 81 dt. 18.12.2023.

KËSHILLIT TË BASHKISË.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e saj nr.11788, datë 04.09.2024, në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ka dërguar detajimin e fondeve që alokohen për rritjen e pagave të punonjësve për vitin 2024 për Bashkinë Patos, me vlerë 9,731,030 lekë.

Nisur nga llogaritjet dhe analizës për nivelin e rritjes, paraqesim ndarjen e këtij fondi sipas tabelës bashkëlidhur Projekt - Vendimit.

Për Drejtorinë e Financës
Mimoza Shtëmbari

Për Sektorin Juridik

Nurkë Hazizaj

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Juela Shpata

**Kryetari
Fation Duro**

